


PERFORMANCA E KUVENDIT KOMUNAL TË DRAGASHIT GJATË VITIT 2014



**SHKURT 2015,
DRAGASH**



Publikuar nga CIDD (Qendra për Integrim dhe Zhvillim në Dragash)

Email: info@cidd-dragash.org, m.zejnullahu@cidd-dragash.org

Website: <http://www.cidd-dragash.org>

Dragash (2015). Monitorimi i transparencës së Kuvendit Komunal të Dragashit – Performanca e Kuvendit Komunal Dragash për vitin 2014

Sqarim:

Projekti i OJQ-së CIDD **"Monitorim efikas, për një transparencë dhe përgjegjshmëri"** është implementuar që nga fillim viti 2014, dhe i gjithë projekti është implementuar vullnetarisht nga anëtarë vullnetarë të OJQ-së Qendra për Integrim dhe Zhvillim në Dragash.

Të gjitha të drejtat në përdorimin e këtij publikimi janë të rezervuara. Pjesë të këtij raporti nuk mund të përdoren në çfarëdo forme pa ju referuar materialit burimor. Ky raport mund të transferohet përmes formave elektronike dhe mund të fotokopjohet duke mos humbur origjinalitetin e tij.

PERFORMANCA E KUVENDIT KOMUNAL TË DRAGASHIT

2014

1	Hyrje	4
2	Qëllimi.....	4
3	Përfaqësimi në KK të Dragashit	6
4	Zgjedhja e organeve dhe komiteteve të Kuvendit	7
5	Përformanca e kuvendareve gjatë periudhës raportuese	8
6	Propozimet dhe Rekomandimet e shoqërisë civile.....	12

1. HYRJE

Në periudhën e monitorimit të performancës së Kuvendit Komunal të Dragashit gjatë vitit 2014 janë mbajtur gjithsej 11 seanca, 10 të rregullta dhe një e jashtëzakonshme.

Qëllimi i publikimit të këtij raporti është informimi i paanshëm dhe objektiv i qytetarëve për punën e të zgjedhurve të tyre gjatë mbajtjes së seancave të Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2014.

Organizata “Qendra për Integrim dhe Zhvillim në Dragash” ka bërë monitorimin e drejtpërdrejtë të këtyre seancave dhe në këtë raport në detaje do të mundohemi që të pasqyrojmë ecurinë e këtyre seancave, diskutimet dhe çështjet e ngritura në këto seanca.

Në 11 seancat e mbajtura gjatë vitit raportues janë shqyrtuar gjithsej 41 pika të rendit të ditës.

Vlerësimet e paraqitura në këtë raport janë të bazuara në vëzhgimin e drejtpërdrejtë dhe objektiv të punimeve të kuvendit komunal. Monitoruesit e Qendrës për Integrim dhe Zhvillim në Dragash kanë përcjellë të gjitha seancat e Kuvendit Komunal gjatë periudhës janar – dhjetor 2014. Këshilltarët komunalë dhe subjektet politike janë vlerësuar në mënyrë individuale në kategori të caktuara të cilat më pas reflektojnë performancën dhe angazhimet e tyre në përgjithësi. Rezultatet e vlerësimeve janë të shprehura në përqindje % dhe shifra.

Në këto seanca të kuvendit komunal të Dragashit delegatët prezent kanë zhvilluar gjithsej rreth 572 diskutime të ndryshme, ndërsa kryetari i komunës rreth 30 diskutime, ndërsa ushtruesit e detyrës së Drejtorëve të drejtoratëve përkatëse kanë marrë fjalën gjithsej 18 herë gjatë këtyre seancave.

2. QËLLIMI

Qëllimi i raportit është të krijojmë informim të drejtë për qytetarët lidhur me aktivitetet e të zgjedhurve të tyre lokal. Raporti shërben si një mjet për të rritur transparencën e Komunave gjatë ushtrimit të aktiviteteve dhe kryerjes së përgjegjësiave të tyre. Në raport janë përfshirë të dhëna të përgjithshme rreth funksionimit të Kuvendit të Komunës. Po ashtu, përfshihen edhe gjetjet më të rëndësishme të evidentuara gjatë periudhës raportuese.

Synim i yni primar është pasqyrimi i drejtë i punës dhe aktiviteteve të ndërmarra nga ana e Kuvendit Komunal të Dragashit gjatë vitit 2014. Në këtë këtë raport ofrohen të dhëna të

besueshme lidhur me ecurinë e seancave të kuvendit komunal për arsye se anëtarë të OJQ-së CIDD në vazhdimësi kanë marrë pjesë në seancat e rregullta të kuvendeve të komunave, duke evidentuar ecurinë e punës së kuvendeve komunale të performancës së kuvendarëve dhe respektimit të kornizës ligjore nga ana e tyre.

OJQ CIDD për të adresuar interesat dhe brengat të qytetarëve në mënyrë të paanshme dhe apartiake u ofron qytetarëve informata në mënyrë të vazhdueshme lidhur me ecurinë e punës së mekanizmave lokale në Komunën e Dragashit. Synimi i monitorimit të seancave të kuvendit komunal është ndërtimi i një shoqërie të qëndrueshme demokratike. Qëllimet e monitorimi të punës së zyrtarëve të zgjedhur janë:

- Që të sigurohet një transparencë më e madhe e organeve vendimmarrëse në të ardhmën;
- Që të sigurohet përgjegjshmëria e zyrtarëve të zgjedhur ndaj qytetarëve dhe që ata të jenë përfaqësues të vërtetë të interesave të shoqërisë;
- Që të sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrjen lokale;
- Që sadopak të parandalohen parregullsitë e mundshme, pa përgjegjshmëria dhe kërcënimet;
- Që të inkurajohen zyrtarët e zgjedhur në punën e tyre për gjetjen e zgjidhjeve që rëndojnë komunitetin dhe shoqërinë civile;
- Që të krijohet një urë ndërlidhëse bashkëpunimi në mesë zyrtarëve të zgjedhur, shoqërisë civile dhe komunitetit;

3. PËRFAQËSIMI NË KUVENDIN KOMUNAL TË DRAGASHIT

Zgjedhjet Lokale të mbajtura në 12 Dhjetor të vitit 2013 mund të konsiderohen si zgjedhje korrekte dhe demokratike të cilat në komunën e Dragashit janë përcjellë në një frymë tolerante dhe pa probleme të theksuara. Ne zgjedhjet për delegatë në kuvendin komunal të Dragashit, PDK (Partia Demokratike e Kosovës) del si subjekt më i përfaqësuar në Kuvendin e Komunës së Dragashit. Kjo parti në këto zgjedhje lokale ka fituar 4224 vota dhe që do të përfaqësohet me 8 delegatë në kuvendin komunal i cili përbëhet nga 27 delegatë gjithsej.

Subjekti i dytë politik më i përfaqësuar me numër të delegatëve në Kuvendin e Komunës së Dragashit del LDK (Lidhja Demokratike e Kosovës), subjekt ky i cili në zgjedhjet lokale 2013 ka marrë 3915 vota dhe që do të jetë e përfaqësuar me 7 delegatë në legjislaturën 2013 - 2017.

Subjekti i tretë politik në zgjedhjet lokale 2013 në Kuvendin e Komunës së Dragashit radhitët Centar Demokratske Unije (CDU) subjekt ky i komunitetit Bosnjako-goran, i cili është krijuar vetëm disa javë para mbajtjes së zgjedhjeve lokale të vitit 2013, dhe arriti të jetë subjekti më i votuar minoritar, e që përfaqësohet me 4 delegatë në Kuvendin Komunal.

Pesë subjekte tjera të cilat kanë fituar mandat në Kuvendin e Komunës së Dragashit janë:

VAKAT e cila do të përfaqësohet me 3 delegatë, AAK-LDD që do të përfaqësohet me 2 delegatë, BD me 1 delegatë, e që duhet theksuar se edhe Bashkimi Demokratik (BD) është subjekt i cili ka garuar për herë të parë në zgjedhjet e 2013, AKR do të përfaqësohet me 1 delegatë dhe GIG me një delegat, e të cilët të gjithë së bashku bëjnë 27 delegatë. Në legjislaturën e tashme të kuvendit komunal shihet një përfaqësim më i madh i komunitetit Boshnjako-Goran i cili doli më masovisht në zgjedhje dhe arriti që në këtë legjislaturë të përfaqësohet me 8 delegatë, për dallim nga legjislatura e kaluar që u përfaqësua me 5 delegatë.

4. ZGJEDHJA E ORGANEVE DHE KOMITETEVE TË KUVENDIT

Ashtu siç u zhvilluan zgjedhjet komunale në një frymë të qetë dhe demokratike, ashtu u zhvillua edhe seanca inauguruese në një frymë bashkëpunimi të ndërsjellët të subjekteve Shqiptare dhe Gorane. Seancën e udhëhoqi delegati më i moshuar Z. Halim Shemsidini nga LDK (Lidhja Demokratike e Kosovës). Në këtë seancë dhanë betimin sipas agjendës të gjithë delegatët e Kuvendit Komunal dhe kryetari i zgjedhur i Komunës Z. Salim Jonuzi. Në fund në një konkurrencë demokratike në mes Z. Shaban Shabani (PDK) dhe Z. Granit Rifaj (PDK) u zgjodh Z. Shaban Shabani me 15 vota për, si kryesues i Kuvendit Komunal të Dragashit për mandatin katër vjeçar (2013 – 2017). Kjo ndodhi në seancën inauguruese të mbajtur me datë 26 dhjetor 2013. Gjithashtu u zgjodh edhe Zv. Kryesuesi i kuvendit komunal nga komunitetet Z. Adem Hoxha nga subjekti më i madh Boshnjako – Goran CDU.


Konstituimi i organeve komunale vazhdoi në seancën e radhës të parën për vitin 2014 që u mbajte më datë 23 janar 2014 ku u themeluan edhe dy Komiteteve obligative të Kuvendit Komunal, gjegjësisht Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete. Kur u duk se konstituimi i organeve të Kuvendit komunal do të shkonte shumë mirë, pikërisht në seancën e tretë ngeci puna për zgjedhën e nënkryetarit të Komunës së Dragashit nga komunitetet, e cila edhe pas mbajtjes së 12 seancave të kuvendit komunal gjatë këtij mandati akoma nënkryetari i komuniteteve nuk është zgjedhur.

Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale obligon kuvendin komunal që të zgjedh një nënkryetar për komunitete në komunat ku komuniteti jo shumicë përbën më shumë se 10% të popullatës së komunës. Kështu që kryetari i komunës obligohet që ti paraqes kuvendit për votim një kandidatë nga komuniteti për tu zgjedhur si nënkryetar i komunës. Kryetari i Komunës së Dragashit në kundërshtim me Nenin 4, pikën 1 të Udhëzimit Administrativ MAPL 2014/01 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna, propozoi jo një po dy kandidatë për Nën-Kryetar, e që kjo komplikoi situatën ngase duhet të votonin 8 delegatë nga komuniteti Goran, e që doli që gjatë 3 votimeve rezultati të jetë 4 - 4, dhe që nga ajo kohë komuna e Dragashit edhe pas 11 seancave akoma nuk ka arritur të zgjedh një nënkryetar për komunitete edhe pse kanë kaluar mbi 1 vit kohë që prej kur janë bërë propozimet e para nga kryetari i Komunës në seancën e tretë të mbajtur në muajin shkurt.


5. PERFORMANCA E DELEGATEVE GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë vitit 2014, kuvendi komunal i Dragashit ka thirr një (1) seancë të jashtëzakonshme dhe ka mbajtur dhjetë (10) seanca të rregullta duke nxjerrë 22 vendimeve të caktuara, ndërsa gjatë kësaj periudhe raportuese nga ky kuvend nuk është nxjerrë asnjë rregullore përveç amendamentimit të Rregullores për Taksa dhe ngarkesa tjera komunale.


Gjatë periudhës raportuese delegatet e Kuvendit të Komunës së Dragashit kanë zhvilluar gjithsej 532 diskutime, e ku me diskutime prin subjekti politike LDK (Lidhja Demokratike e Kosovës) me 157, ndërsa më pak diskutime ka subjekti politik AKR me 31 gjithsej.




Sa i përket Inicimit të çështjeve të caktuara, më së shumti çështje ka iniciuara LDK me 11 të tilla ndërsa më së paku AAK me 1 çështje të iniciuara.



Kur jemi tek çështjet të cilat janë shqyrtuara nga gjithsej 37 më 15 prej tyre kanë qenë çështje procedurale, ashtu siç mund ti shihni në diagramin e mëposhtëm:



Kurse gjatë 11 seancave të kuvendit komunal të Dragashit janë shqyrtuar gjithsej 61 çështje të ndryshme ku rreth 40% e tyre kanë qenë procedurale, pastaj prijë ato ambientale, ekonomike e kështu më radhë:



Performanca e delegateve të Kuvendit Komunal të Dragashit për vitin 2014

Nr.	Delegatet	Subjekti politik	Propozim për rend dite	Pjesëmarrje në diskutim	Propozime	Inicimi i çeshtjeve	Inicimi i rregullorëve	Pyetjet parlamentare	Përdorimi i gjuhës jo-parlamentare	Lëshimi i seancës përkoasht	Lëshimi i përhershëm	Mungesa në seanca	Diskutimet e delegateve	Përqindja e pjesëmarrjes në debatë
1	Shaban Shabani	PDK	0	0	0	0		0		1	0	0	0	0.00%
2	Emin Kolloni/ Ymridin Fetahu	PDK	0	19	1	4		4		7	0	1	28	5.26%
3	Granit Rijaj	PDK	1	11	0	5		2		11	0	1	19	3.57%
4	Vehbi Nazifi	PDK	0	17	3	0		1		9	0	0	21	3.95%
5	Artan Loshaj	PDK	0	10	2	0		2		13	0	0	14	2.63%
6	Nazmije Velija	PDK	0	10	0	0		0		11	0	0	10	1.88%
7	Samire Meleqi	PDK	0	7	1	0		0		3	0	2	8	1.50%
8	Arbenora Kryeziu	PDK	0	6	1	1		0		4	0	0	8	1.50%
9	Halim Shemsidini	LDK	0	20	8	1		1		9	0	2	30	5.64%
10	Samidin Xheladini	LDK	0	36	0	4		1		10	0	0	41	7.71%
11	Kapllan Fetahu	LDK	0	24	3	3		5		3	0	0	35	6.58%
12	Bahtijar Berisha	LDK	3	26	2	3		6		14	0	2	40	7.52%
13	Arijeta Skeraj	LDK	0	0	0	0		2		10	0	0	2	0.38%
14	Shqipe Halili	LDK	0	4	0	0		0		3	1	1	4	0.75%
15	Kaltrina Krasniqi	LDK	0	4	1	0		0		3	3	0	5	0.94%
16	Adem Hodza / Nevzat Hamza	CDU	0	11	0	0		0		0	0	3	11	2.07%
17	Hajrudin Hodza	CDU	0	15	0	2		4		5	0	0	21	3.95%
18	Melisa Sola	CDU	0	3	0	0		0		3	0	1	3	0.56%
19	Mersiha Memisi	CDU	0	1	0	0		0		1	3	0	1	0.19%
20	Serif Aga	VAKAT	1	24	1	2		2		6	0	0	30	5.64%
21	Veljid Hadzisin	VAKAT	1	31	3	3		3		3	0	0	41	7.71%
22	Zinaida Elmazi	VAKAT	0	13	2	1		0		10	0	1	16	3.01%
23	Ymridin Krasniqi	AAK	0	13	1	0		1		11	1	2	15	2.82%
24	Luljeta Berisha	AAK	0	15	1	1		2		11	0	0	19	3.57%
25	Nexhat Isufi	BD	1	27	4	4		4		7	0	0	40	7.52%
26	Zaim Hajredini	AKR	1	21	1	2		6		10	0	0	31	5.83%
27	Deir Jelmazi	GIG	0	34	1	2		2		4	0	0	39	7.33%
28	Salim Jonuzi	Kryet.	0	30	0	0		0		0	0	0	30	0.00%
29	Drejtoret	drejt	0	18	0	0		0		0	0	0	18	0.00%
			0	0	0	0		0		0	0	0	0	0.00
			0	0	0	0		0		0	0	0	0	0.00
Me numra janë përshkruar sasia e veprimeve përkatëse të theksuara lartë!													532	100%

Delegatet me më shumë diskutime

Nga tabela e më sipërme del se kemi 2 delegatë që kanë shënuar nivel më të lartë të diskutimeve të përgjithshme gjatë seancave të vitit 2014, dhe ata janë: Samidin Xheladini nga LDK dhe Velid Hadzisin nga VAKAT me nga 41 diskutime apo me nga 7.71% diskutime nga numri i përgjithshëm i diskutimeve. Pastaj kemi delegatet Nexhat Isufi BD dhe Bahtijar Berisha LDK me nga 40 apo me nga 7.52%.

Kandidatet më më së shumti diskutime		
Emri dhe mbiemri	Subjekti politik	Përqindja
Samidin Xheladini	LDK	7.71%
Velid Hadzisin	Vakat	7.71%
Nexhat Isufi	BD	7,52%
Bahtijar Berisha	LDK	7.52%
Deir Jelmazi	GIG	7,33%
Kapllan Fetahu	LDK	6,58%

Delegatët me më shumë mungesa gjatë seancave

Si çështje negative e vërejtur është edhe lëshimi i përkohshëm disa minutesh i seancave nga delegatet e asamblesë. Delegatët që më së shumti kanë lëshuar seancat përkohësisht janë: Bahtijar Berisha, Artan Loshaj, Granit Rifaj, Ymridin Krasniqi dhe Luljeta Bersiha dhe Nazmije Velija, ashtu siç mund të shihni nga tabelat në të djathtë.

Kandidatet më më së shpeshti kanë lëshuar përkohësisht seancat kuvendore		
Emri dhe mbiemri	Subjekti politik	nr
Bahtijar Berisha	LDK	14
Artan Loshaj	PDK	13
Granit Rifaj	PDK	11
Ymridin Krasniqi	AAK	11
Luljeta Berisha	AAK	11
Nazmije Velija	PDK	11

Kandidatët më më pak diskutime

Ndërsa kandidatët më pak të angazhuar në diskutime gjatë seancave të kuvendit komunal të Dragashit të mbajtura gjatë vitit 2014 janë: Mersiha Memisi, Arjeta Skeraj, Melisa Sola, etj.

Kandidatët më më pak performancë		
Emri dhe mbiemri	Subjekti politik	Nr.i diskutimeve
Mersiha Memisi	CDU	1
Arjeta Skeraj	LDK	2
Melisa Sola	CDU	3
Shqipe Halili	LDK	4
Kaltrina Krasniqi	LDK	5
Samire Meleqi	PDK	8

6. PROPOZIMET DHE REKOMANDIMET E SHOQËRISË CIVILE PËR KUVENDIN KOMUNAL

Qendra për Zhvillim dhe Integrim në Dragash (CIDD) si organizatë jo qeveritare e përkushtuar për të dhënë kontributin e saj për një qeverisje lokale efikase, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse, gjatë aktiviteteve të monitorimit nga afër të Kuvendit Komunal të Dragashit, ka bërë disa propozime për zhvillimin dhe rritjen e efikasitetit të qeverisjes Komunale.

CIDD vlerëson se tentimi për ndryshimet në numrin e drejtorive komunale, zgjedhja e nënkryetarit të komunës nga komuniteti minoritar, emërimi sa më shpejtë i drejtorëve komunal, bilanci gjinor në emërimin e drejtorëve komunal, dhënia e përgjegjësisë për të rinjtë në vendimmarrje, rifreskimi i websajtit të komunës si dhe transparenca e buxhetit komunal, janë propozime të cilat duhet ti ketë parasysh Kuvendi Komunal i Dragashit gjatë vitit 2015 e të cilat do ndihmojnë dhe avancojnë qeverisjen komunale për më shumë transparencë, llogaridhënie, efikasitet dhe gjithëpërfshirje.

Më poshtë janë propozimet dhe rekomandimet e elaboruara të cilat ju drejtojmë delegateve të Kuvendit Komunal, Kryetarit të Komunës dhe të gjithë mekanizmave përgjegjëse duke besuar se do të merren në konsideratë dhe të shndërrohen në vendime të cilat do të përmirësojnë shërbimet dhe do të bëjnë qeverisjen më transparente dhe të përgjegjshme.

1. Zgjedhja e Nënkyetarit të komunës nga radhët e komunitetit,

Pasi që Kuvendi Komunal ka dështuar të zgjedh nënkryetarin e Komunës nga radhe te komunitetit Goran. Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale obligon kuvendin komunal që të zgjedh një nënkryetar për komunitete në komunat ku komuniteti jo shumicë përbën më shumë se 10% të popullatës së komunës. Kështu që kryetari i komunës obligohet që ti paraqes kuvendit për votim një kandidatë nga komuniteti për tu zgjedhur si nënkryetar i komunës. Kryetari i Komunës së Dragashit në kundërshtim me Nenin 4, pikën 1 të Udhëzimit Administrativ MAPL 2014/01 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna.

2. Zgjedhja e Drejtorëve të drejtorive Komunale,

Vendimi i kryetarit të Komunës për vazhdimin e mandatit të drejtorëve të më parshëm ne si shoqëri civile mendojmë se është jo i qëlluar për faktin se të njëjtët drejtorë që kanë udhëhequr drejtoritë përkatëse të komunës për 4 vite tashti që të gjithë janë ushtrues detyre për më shumë se një vit, pra nga dhjetori i vitit 2013 të gjithë 7 drejtoret e

drejtorive përkatëse ushtrojnë detyrat e tyre si ushtrues detyre, e që besojmë që është shkelle ligjore nga ana e kryetarit, andaj Kuvendi Komunal duhet të ushtroj presionin i tij për të zgjedhur drejtoret e ri të drejtorive komunale.

3. Bilanci gjinor në postet udhëheqëse

CIDD propozon që në emërimin e drejtorëve të rinj, të keni parasysh përfaqësimin e denjë gjinor, të ndani përgjegjësitë mbi baza të balancuara gjinore dhe të krijoni mundësi për gratë që të marrin përsipër detyra dhe përgjegjësi vendimmarrëse. Ne jemi në dijeni për faktin që nga paslufta e gjerë më tani, pra që 14 vjet të qeverisjes lokale asnjëherë dhe në asnjë qeverisje të më parshme dhe të tashme nuk ka pasur ndonjë femër të emëruar në pozita udhëheqëse si drejtorë në drejtoritë komunale apo drejtor të shkollave apo mekanizmave tjerë ku komuna është përgjegjëse. Andaj shpresojmë që në rastin e emërimit të drejtoreve të ri komunal, kryetari dhe kuvendi komunal të merr parasysh bilancin gjinor në pozitat e tilla udhëheqëse.

4. Përfshirja e rinisë në vendimmarrje

Njëjtë si përfaqësimi i grave në postet udhëheqëse, hiq më mirë nuk qëndron edhe përfshirja e të rinjve në vendimmarrje, si në emërimet e tyre në poste të larta udhëheqëse gjithashtu edhe angazhimi i tyre në proceset vendimmarrëse. Shpresojmë që kryetari i ri dhe delegatet e rinj të kuvendit komunal do ti kushtojnë më shumë rëndësi përfshirjes së të rinjve në vendimmarrje.

5. Të emërohet një zyrtarë për Informim

Të funksionalizohet Zyra për Informim e komunës për t'i ofruar qytetarëve informacion orientues dhe për të parandaluar mbingarkesat në administratën komunale, si dhe të publikohet numri i telefonit dhe emaili zyrtar i këtij zyrtari në mënyrë që qytetareve tu mundësohet arritja më e lehtë për tek informacioni.

6. Buxheti dhe shpenzimet të komunës.

CIDD bënë thirrje që drejtorët e rinj komunal të jenë transparentë me paranë e komunës dhe të shfrytëzojnë ueb-faqen e komunës për të publikuar shpenzimet dhe buxhetin e secilës drejtori për çdo muaj, në mënyrë që secili qytetar i komunës mund ta dijë sa është buxheti i komunës, si po alokohet, dhe në çfarë prioritete shpenzohen parat e tyre. Transparenca dhe burokracia në qasje në informacion ka qenë dhe është brengë e qytetarëve të komunës së Dragashit me të cilat CIDD ka mbajtur takime të organizuara me qytetarë dhe ka vërejtur dyshimet e qytetarëve për mos transparencën e buxhetit dhe shpenzimeve në ueb-faqe.

Qendra për Integrim dhe Zhvillim në Dragash beson që ju si delegat të kuvendit komunal dhe gjithashtu si kryetar i komunës do të angazhoheni për përmbushjen e këtyre propozimeve pasi që besojmë që një qeveri lokale efikase shkon në të mirën e të gjithëve.

Gjithashtu, ne si Shoqëri Civile jemi të gatshëm për bashkëpunim dhe për ofrim të ndihmës në çdo kohë, me qëllim që të kemi një qeverisje lokale më transparente, më gjithëpërfshirëse dhe më llogaridhënëse.

7. Rifreskimi i Websajit të Komunës

Websaji i komunës duhet të jetë dritarja ku të gjithë qytetaret të mund të informohen me punën e organeve komunale dhe kuvendit komunal. Por siç jemi në dijeni edhe pse janë bërë disa përpjekje kohëve të fundit ku publikohen thirrjet për seanca dhe vendimet e kuvendit komunal prapë se prapë, sa i përket transparencës së drejtorive dhe publikimit të raporteve të shpenzimeve dhe raporteve të punës së këtyre drejtorive, thuajse asgjë nuk është publikuar në websajtin e komunës së Dragashit. Raportet tre (3) mujore dhe gjashtë (6) mujore të shpenzimeve të organizatave buxhetore, sipas ligjit duhet të publikohen në websajtin e organizatave të tilla buxhetore, por këto raporte nuk mund të gjenden në websajtin e komunës. Gjithashtu edhe vendimet për pranimin e personelit në punë fare nuk janë publikuar në websajtin e komunës. Gjithashtu praktik e mirë do të ishte që paraprakisht të publikohen në websajt të gjitha aktet dhe vendimet komunale në formen e tyre preliminare para së të fuqizohen.

Kështu që OJQ Qendra për Integrim dhe Zhvillim në Dragash shpreson që legjislativi dhe ekzekutivi lokal të merr parasysh këto propozime gjatë punës së tyre në vitin 2015.

Qendra për Integrim dhe Zhvillim në Dragash

Shoqata jo qeveritare “Qendra për Zhvillim dhe Integrim në Dragash” është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e themeluar në vitin 2012 dhe e regjistruar më datë 09.10.2012 e që posedon certifikatën e regjistrimit nr. 5114141-5.

Shoqata Qendra për Integrim dhe Zhvillim “C.I.D.D” është themeluar me qëllim të:

- Monitorimit dhe vlerësimit të mekanizmave dhe institucioneve komunale,
- Përkrahje për iniciativat qytetare
- Integrimi i minoritetit në shoqëri
- Kujdesin që duhet kushtuar mbajtjes së higjienës nga ana e shoqërisë civile dhe mbrojtjes së ambientit jetësor,
- Hulumtimit të opinionit publik,
- Organizime të ndryshme rreth trajtimit të të drejtave të njeriut,
- Organizime të sondazheve të ndryshme me theks të veçantë në sundimin e rendit dhe ligjit,
- Organizimi i trajnimeve të ndryshme rreth të drejtave të komunitetit pakicë,
- Organizimin e aktiviteteve rinore dhe përfshirjen e rinisë në vendimarrje,
- Integrimin të femrës në shoqëri dhe shkollimin e tyre, etj.

Për t’i përmbushur qëllimet e saj, organizata ka ndërmarrë, iniciative vetëdijesuese dhe promovuese, aktivitete kulturore për promovimin e kulturës, botim të librave, seminare, tribuna shkencore, organizim të aktiviteteve rinore e koncerteve, takime pune, fushata të organizuara për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të njeriut, përparimin e barazisë gjinore, zhvillimi i materialeve propaganduese për promovimin e ligjit dhe rregullative ligjore të dobishme për shoqërinë, iniciativa për mbrojtjen e ujit të pijshëm, ambientit të pastër jetësor, zhvillimin e turizmit dhe krijimin e kushteve për një vetpunsim të popullatës rurale që jeton në komunën tonë, etj.

Shoqata CIDD, ka gjithsejtë 21 anëtar të rregullt ku 90% e tyre kanë përgatitje superiore. Në anëtarësinë e shoqatës janë të përfshira 5 anëtare të gjinisë femërore ku 4 nga to janë me përgatitje superiore, ndërsa në anëtarësinë pasive (të angazhuar kohë pas kohe) kemi mbi 100 anëtarë në gjithë komunën e Dragashit.

Një përfaqësues i OJQ-së “CIDD”, është anëtar i rregullt në ‘Mekanizmin komunal kundër dhënës në familje’ i cili është institucionalizuar në komunën e Dragashit. OJQ “CIDD” ka realizuar disa projekte në shërbim të qytetareve, e që ka pasur një partneritet të shkëlqyer me mekanizmat komunal si me kryetarin e komunës gjithashtu edhe me kuvendin komunal, me UNDP-në dhe USAID-in të cilat së fundmi kanë qenë donator të projekteve të ndryshme të realizuara nga “CIDD”, pastaj ka partneritet me disa OJQ tjera lokale ka që veprojnë përgjithësisht në komunën e Dragashit dhe që bashkërisht ka realizuar disa aktivitetete të ndryshme, qëllimi i të cilave ka qenë integrimi dhe arsimimi i femrës në komunën e Dragashit, parandalimi i dhunës në familje, integrimi i komuniteteve, etj. OJQ “CIDD” ka partneritet edhe me organizata të ndryshme dhe iniciativa të ndryshme regjionale me të cilat së fundmi ka zhvilluar një partneritet të shkëlqyer.

Që nga themelimi OJQ CIDD ka realizuar rreth 10 projekte të ndryshme në fusha të interesit të përgjithshëm shoqëror, dhe gjithashtu edhe në të ardhmen në bashkëpunim me organizatat tjera dhe mekanizmat lokale do të jetë aktive në çështjet që preokupojnë qytetaret e komunës së Dragashit.